



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.399/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.06.2019 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Medi-Tel” sh.p.k nga procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr. REF-16580-04-03-2019 me objekt “*Evadim i mbetjeve spitalore per nevoja te DSR Diber per vitin 2019*“ me Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës 1,999,950 leke pa TVSH, zhvilluar në datën 23.04.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Spitalit Rajonal Diber.
- Ankimues:** “Medi-Tel”
Autostrada TR-DR, Km 1, Rruga Vidhegiate, Mëdërtesa nr.18, Kashar Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria Spitalit Rajonal Diber
Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për*

miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 03.04.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr. REF-16580-04-03-2019 me objekt “*Evadim i mbetjeve spitalore per nevoja te DSR Diber per vitin 2019*” me Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës 1,999,950 leke pa TVSH, zhvilluar në datën 23.04.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Spitalit Rajonal Diber.

II.2. Në datën 23.04.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 30.04.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | | |
|------------------|--------------|----------------|
| - Pura Medical | pa ofertë | I skualifikuar |
| - Medi Tel | 1,726,623.50 | I skualifikuar |
| - Vale Recycling | 1,979,950.50 | I kualifikuar |
| - Eco Riciklim | 3,266,585 | I skualifikuar |

II.4. Në datën 30.04.2019 operatori ekonomik Medi-Tel shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Nuk plotëson kapacitetin teknik të përcaktuar në pikën a-, të seksionit 2.1 pasi ofertuesi nuk ka paraqitur Leje Mjedisit të Tipit A , me kod III.1.C sipas parashikimeve të Ligjit 10448 datë 14/07/2011 “Per lejet e mjedisit”I ndryshuar I vlefshem ne daten e hapjes se procedures.*
- *Nuk plotëson kërkesën tekniko-profesione të përcaktuar në pikën 4 të seksionit 2 pasi ofertuesi nuk ka paraqitur nje inxhinier elektrik per te siguruar funksionimin e paisjeve te impiantit te paisur me “Certifikate Kualifikimi”, dhe “Leje perdorimi paisje nen presion” te vertetuar nga diploma, kontrata e punes dhe listepagesa per nje periudhe sa sherbimi i kerkuar, pasi inxhinieri elektrik i paraqitur eshte i specializuar ne meqatronik dhe inxhinieri elektronike jo ne objektin e kerkuar ne DST.*
- *Nuk plotëson kërkesën tekniko-profesione të përcaktuar në pikën 4 të seksionit 2 pasi ofertuesi nuk ka paraqitur Drejtues teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, deklaratën që nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të pakten 6 muajt e fundit por ka paraqitur vetem listpagesen e muajve janar-shkurt 2019 , dhe ing, mekanik e ka te punesuar me kohe te pjeseshme, si specialist dhe te profilit teknolog.*

II.5. Në datën 06.05.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit sqarojmë se operatori ekonomik Medi Tel shpk disponon Leje Mjedisit të tipit A me Kod III.1.C sipas parashikimeve të ligjit 10448 datë 14.07.2011 Për lejet e mjedisit i ndryshuar e lëshuar kjo nga organet kompetente ligj zbatuese në fushën e mjedisit. Operatori ekonomik Medi Tel shpk mbasi ka shqyrtuar kërkesat për kapacitetin ligjor/prpfesional referuar DST (shtojcë në DT nr.1 dtaë*

16.04.2019), ka ngarkuar në SPE dokumentin ligjor të kërkuar nga AK. Lidhur me këtë argument ju dërgojmë përsëri në format hard copy dokumentin Leje Mjedisit të Tipit A me Kod III.1.C sipas parashikimeve të ligjit 10448 datë 14.07.2011 për Lejet e Mjedisit i ndryshuar i vlefshëm në datën e hapjes së procedurës.

- Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit sqarojmë si vijon: Referuar shtojcës nr.1 datë 16.04.2019 të ngarkuar në SPE nga ana juaj si AK na bëni me dije që janë ndryshuar kërkesat për kapacitetin e kërkuar për Ing Elektrik. Ndërkohë në vlerësimin tuaj ju i referoheni kërkesave në DST të hartuar dhe të publikuar nga ana juaj më datë 04.04.2019 për kapacitetet e kërkuara për ing elektrik dhe jo duke ju referuar shtojcës nr.1 datë 16.04.2019 dhe keni krijuar një konfuzion në vlerësim dhe duke shkelur LPP. Sqarojmë se operatori Medi tel shpk pasi ka shqyrtuar kërkesat për kapacitetin teknik referuar DST shtojcë në DT nr.1 datë 16.04.2019 ka ngarkuar në SPE dokumentacionin e kërkuar si më poshtë vijon:

1. Kontratë Individuale e Punës me Ing Elektrik

2. Diplomë të shkollës së lartë Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike profili automatizim industrie. Në DST apo në shtojcë nuk keni kërkuar Diplomë Bachelor apo Master të Shkencave , referuar sa më lart nuk mund të pretendoni që nuk ka kualifikimin e duhur si Ing Elektrik.

3. Dëshmi Kualifikimi në profesionin e Ing Elektrik për punonjësit që punojnë me impiantet, pajisjes dhe instalimet elektrike apo në afërsi të tyre. Referuar shtojcës 1 datë 16.04.2019 të publikuar nga AK keni hequr kriterin Leje përdorimi pasjisje nën presion dhe nuk mund të pretendoni që ne si OE të ngarkojmë dokumenta të cilat nuk këkrohen nga ana juaj si AK.

4. Referuar seksionit 2 pika 3 të kriterit OE pjesëmarres ne procedure duhet te kene te punesuar te pakten nje **inxhinier elektrik** per te siguruar funksionimin e paisjeve te impiantit te paisur me “Certifikate Kualifikimi”, nuk keni përcaktuar terminologjinë të lidhur me listpagesa për një periudhë sa shërbimi i kërkuar. Në këto kushte kjo arësye nuk qëndron për të na skualifikuar ne si OE.

- Lidhur me arsyen e tretë të skualifikimit se -Nuk plotëson kërkesën tekniko-profesione të përcaktuar në pikën 4 të seksionit 2 pasi ofertuesi nuk ka paraqitur Drejtues teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, deklaratën që nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera,si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per te pakten 6 muajt e fundit por ka paraqitur vetem listepagesen e muajve janar-shkurt 2019, sqarojmë se: Referuar shtojcës nr.1 datë 16.04.2019 të ngarkuar nga ana juaj na bëni me dije ndryshimet e reflektuara në kërkesat e kërkuara. Në si OE mbasi kemi shqyrtuar

kërkesat për kapacitetin teknik referuar shtojcës nr.01 datë 16.04.2019 kemi ngarkuar dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- 1. CV për Ing Mjedisi*
 - 2. Kontratë Pune të vlefshme për Ing Mjedisi*
 - 3. Diplomë e Nivelit të Parë për Ing Mjedisi dhe diplomë Master i Shkencave në Mjedis.*
 - 4. Librezë Pune të Ing Mjedisi*
 - 5. Deklaratë që nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera për Ing Mjedisi*
 - 6. Listpagesat e shoqërisë Medi –Tel për Ing Mjedisi për periudhën nga Janar Dhjetor 2018 deri Janar-Shkurt 2019 që e tejkalon kriterin e vendosur nga ana juaj prej 6 muajsh. Ndërkohë që pretendimi juaj që ne kemi dorëzuar vetëm listpagesat Janar-Shkurt 2019 nuk është i vërtetë.*
- Lidhur me arsyen e skualifikimit për Ing Mekanik sqarojmë si vijon: Referuar shtojcës nr.1 datë 16.04.2019 të ngarkuar nga ana juaj na bëni me dije ndryshimet e reflektuara në kërkesat e kërkuara. Në si OE mbasi kemi shqyrtuar kërkesat për kapacitetin teknik referuar shtojcës nr.01 datë 16.04.2019 kemi ngarkuar dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:*
- 1. CV të Ing Mekanik*
 - 2. Diplomë të Ing Mekanik të noterizuar*
 - 3. Deklaratë që nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera për Ing Mekanik*
 - 4. Kontratë Pune të Vlefshme për Ing Mekanik dhe lidhur me këtë kriter AK nuk ka specifikuar nëse Ing Mekanik duhet me kohë të plotë apo të pjesshme përderisa ky Ing Mekanik figuron në listpagesat e kompanisë për periudhën Janar Dhjetor 2018 dhe Janar Shkurt 2019 që e tejkalon dhe kriterin e vendosur nga ana juaj prej 6 muajsh.*

II.6. Me shkresën nr. 5/9 prot datë 13.05.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës në dispozitiv por ne përmbajtje të saj i është pranuar për arsyen e parë të skualifikimit , leje mjedisore.

II.7. Në datën 20.05.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.564/2 prot datë 10.06.2019 protokolluar me tonën me nr.888/2 prot datë 14.06.2019 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e

Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Medi-Tel” shpk mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Nuk plotëson kërkesën tekniko-profesione të përcaktuara në pikën 4 të seksionit 2 pasi ofertuesi nuk ka paraqitur Drejtues teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, deklaratën që nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit por ka paraqitur vetëm listpagesën e muajve janar-shkurt 2019” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën nr 1 datë 16.04.2019 “modifikim mbi dokumentat e tenderit”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë :

2. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar Drejtues teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, deklaratën që nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit.

Nr.	Profesioni <i>(stafi teknik)</i>	Nr. i Punonjesve
1	<i>Inxhinier Mjedisi</i>	<i>1 (nje)</i>
2	<i>Inxhinier Kimik</i>	<i>1 (nje)</i>
3	<i>Inxhinier Mekanik (per impiante)</i>	<i>1 (nje)</i>

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues “Medi Tel” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Pune datë 06.05.2016, lidhur ndërmjet Shoqërisë Medi Tel shpk dhe Armand Konduri me detyrë Drejtues Teknik i shoqërisë, Diplomë e Nivelit të Parë në Inxhinieri Mjedis, Diplomë Master i Shkencave në Mjedis profili Energjitikë, Librezë Pune, CV, deklartaë që nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, Listpagesat për periudhën Janar 2018-Shkurt 2019
- Kontratë Pune datë 02.08.2018 lidhur ndërmjet Shoqërisë Medi Tel shpk dhe Ervin Kristo me detyrë Drejtues Teknik tek Departamenti i Dezinsektim, Dezinsektim, Deratizim, dhe Ing Kimist i shoqërisë Medi Tel shpk, Certifikatë për Vlerëimin e e Ndikimit në Mjedis, CV, Diplomë Master i Shkencave në Inxhinieria e Proceseve Kimike, Diplomë e Nivelit të Parë në Kimi Industriale dhe Mjedisore, Librezë Pune, deklartaë që nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, Listpagesat për periudhën Janar 2018-Shkurt 2019
- Kontratë Pune datë 01.01.2019 lidhur ndërmjet Shoqërisë Medi Tel shpk dhe Merita Laçi me detyrë specialiste , CV, Diplomë Ing Mekanike, deklarataë që nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe punon me kohë të pjesshme në shoqërinë Medi Tel shpk, Listpagesat për periudhën Janar 2018-Shkurt 2019

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.4 Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) *licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose*
- c) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- ç) *dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.1.5. Referuar parashtrimeve në ankesë vetë ankimuesi pranon se ka dorëzuar në sistimin e prokurimeve elektronike Listpagesat e shoqërisë Medi –Tel për periudhën nga Janar Dhjetor 2018 deri Janar-Shkurt 2019. KPP konstaton se në shtojcën modifikim mbi dokumentata e tenderit është përcaktuar shprehimisht se” *Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar Drejtues teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, deklaratën që nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per te pakten 6 muajt e fundit.* Referuar datës së zhvillimit të procedurës 23.04.2019 në 6 mujorin e fundit përfshihet muaji Mars 2019 qe do të thotë që operatori ekonomik në përmbushje të kriterit duhet të kishte dorëzuar listpagesat për periudhën Tetor 2018-Mars 2019. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Medi Tel shpk rezulton se nuk është paraqitur listpagesa e Muajit Mars 2019.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ”Medi Tel” shpk nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriterin e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit pasi referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi duhet të ishte dorëzuar listpagesa e muajit Mars 2019.

III.1.6. Në rastin konkret, K.P.P gjykon se ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës *onus probandi incubit actor* (barra e provës i bie kërkuesit). Operatori ekonomik ankimues për faktin e mosdorëzimit të dokumentacionit të plotë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike pretendon se i është referuar shtojcës 1 datë 16.04.2019 por nga shqyrtimi i shtojcës nuk rezulton që të mos jetë kërkuar listagesa për 6 muajt e fundit ku përfshihet edhe muaji Mars 2019. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi, në respekt të parimit të barazisë dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve parashikuar nga neni 2 gërma “c” e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: “Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”; “Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues “Medi Tel” shpk shpk duhet të kishte paraqitur dokumentacionin të plotë në përputhje dhe kriteret kualifikuese.

III.1.7. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatorët ekonomikë ankimues do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë dhe operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve

të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Medi Tel” shpk për procedurën e prokurimit, “*Kërkesë për Propozime*”, me nr. REF-16580-04-03-2019 me objekt “*Evadim i mbetjeve spitalore per nevoja te DSR Diber per vitin 2019*“ me Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës 1,999,950 leke pa TVSH, zhvilluar në datën 23.04.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Spitalit Rajonal Diber.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 888 Protokoli; Datë 20.05.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha